



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1322/9 prot.

Datë 13.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 647/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 587/2026, datë 05.05.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “Furnizim – Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05 2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec Sh.A.
- Ankimues:** “Bajro Bros” SHPK me NIPT M113130290 dhe adresë: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial Magnet , Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017 , Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec Sh.A, me adresë: Rruga e Gurasit , Guras Pogradec.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit 2 Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 05.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 587/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “Furnizim –Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A.*
  2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
  3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
  4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK.*
  5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
  6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.2. Me shkresën nr. 416 prot., datë 11.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1322/6 prot., datë 12.05.2026, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 587/2026, datë 05.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “ Furnizim – Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05 2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A.

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 416 prot., datë 11.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1322/6 prot., datë 12.05.2026, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 587/2026, datë 05.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “ Furnizim – Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05 2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 416 prot., datë 11.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1322/6 prot., datë 12.05.2026, rezulton, se autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 587/2026, datë 05.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.587/2026, datë 05.05.2026, nga ku rezultoi, se autoriteti kontraktor ka kryer modifikim dhe publikimin e shtojcës së kësaj procedure, në zbatim të vendimit të Komisioni i Prokurimit Publik nr. 587/2026, datë 05.05.2026.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 587/2026, datë 05.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “ Furnizim – Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05 2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

